



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:238657
Datë: 08.10.2024
Numri i dokumentit: 06268954

K.Dh.Sh II.nr.103/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekomi i Kosovës” Sh.a me seli në rrugën Dardania p.nr. në Prishtinë kundër debitorit “Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve” me seli në rrugën Bedri Gjina p.nr. në Mitrovicë, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokati Lirim Zeka me seli në rrugën Fehmi Agani nr. 138/5 në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2641/22 të datës 31.10.2023, me datë 08.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Telekomi i Kosovës” Sh.a, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2641/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, në aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2641/22 të datës 31.10.2023, ka vendosur si në vijim: Pranohet si të bazuar prapësimin e debitorit “Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe

Pyjeve” me seli në Mitrovicë, ashtu që në tërësi është anuluar urdhri përmbarrimor P.nr.400/2022 i datës 02.12.2022 i përmbarruesit privat Ilmi Miftaraj me seli në Mitrovicë dhe përfundohet në tërësi procedura përmbarrimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak shkeljeve të dispozitave të procedurës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2641/22 të datës 31.10.2023, dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nëpërmjet përgjigjes në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim të drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe drejt ka zbatuar dispozitat materiale, andaj nga gjykata e shkallës së dytë ka kërkuar që refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e kreditorit, ndërsa të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2641/22 të datës 31.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Telekomi i Kosovës” Sh.a, ka paraqitur propozimin për përmbarrim me dt. 01.12.2022, në zyrën e përmbarruesit privat Ilmi Miftaraj me seli në Mitrovicë, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori “Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve” me seli në Mitrovicë që t’ia paguaj shumën prej 419.58€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore. Propozimin për përmbarrim e kishte bazuar në faturën nr. 191031092662/2149 të datës 06.01.2022 të lëshuara nga ai për Debitorin, të cilën në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit.

Përmbarruesi më 02.12.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P.nr.409/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarrimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 12.12.2022 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka pretenduar se nuk është i njoftuar me ekzistimin e faturës lëndore dhe se atë nuk e ka pranuar fare. Në këtë drejtim ka shtuar se fatura lëndore nuk i ka tiparet e përmbareshmërisë, meqenëse nuk e ka pranuar atë në mënyrë të rregullt. Prapësimi nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimiit përmes avokatit.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka kërkuar që propozimi të refuzohet si i pabazuar dhe Urdhri të mbetet në fuqi. Ai ka deklaruar se Debitori nuk ka paraqitur asnjë provë për t'i provuar pretendimet e tij, siç e obligon neni 69 para. 4 i LPP-së. Kreditori ka shtuar se në baza mujore në e-mailin e zyrtarit komunal për menaxhimin e kontratës ia ka dërguar Debitorit fatura, duke përfshirë edhe faturën lëndore. Në këtë drejtim ka shtuar se në vazhdimësi i ka kërkuar përmes e-mailit pagesën e faturës lëndore. Më tej, ka theksuar se Debitori i ka shfrytëzuar të gjitha shërbimet deri më 31.12.2021, ndërsa mos protokollimi i faturës lëndore është çështje e tij e brendshme dhe se kjo nuk e largon nga përgjegjësia për përmbushjen e detyrimeve ndaj tij. Përgjigjes në prapësim ia ka bashkëngjitur disa fatura tjera në emër të Debitorit dhe komunikimin me e-mail për periudhën kohore 07.03.2022 deri 06.10.2022 ndërmjet palëve në këtë procedurë, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2641/22 të datës 31.10.2023, me të cilën e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve” me seli në Mitrovicë, ashtu që në tërësi është anuluar urdhri përmbarimor P.nr.400/2022 i datës 02.12.2022 i përmbaruesit privat Ilmi Miftaraj me seli në Mitrovicë dhe përfundohet në tërësi procedura përmbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se fatura lëndore është lëshuar për periudhën kohore 01.12.2021 deri 31.12.2021, ndërsa në faturë figuron borxhi për këtë periudhë kohore në lartësi prej 59.94€ si edhe borxhi paraparak në lartësi prej 359.64€. Kësisoj shuma

totale e faturës përbëhet nga ngarkesa për periudhën kohore të cekur më lartë si dhe borxhin paraprak, pa treguar se si ka rrjedhur ose për cilën periudhë kohore është borxhi paraprak. Përveç kësaj, gjykata gjen se në faturën lëndore mungon nënshkrimi dhe vula e Debitorit. Në shkresa të lëndës nuk ka prova se Debitori në ndonjë formë e ka pranuar faturën lëndore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Andaj edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se faturat lëndore si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, përmban të meta ngase fatura lëndore është lëshuar për periudhën kohore 01.12.2021 deri 31.12.2021, ndërsa në faturë figuron borxhi për këtë periudhë kohore në lartësi prej 59.94€ si edhe borxhi paraprak në lartësi prej 359.64€. Kësisoj shuma totale e faturës përbëhet nga ngarkesa për periudhën kohore të cekur më lartë si dhe borxhin paraprak, pa treguar se si ka rrjedhur ose për cilën periudhë kohore është borxhi paraprak, po ashtu në faturën lëndore nuk përshkruhet se për cilat shërbime është ngarkuar debitori. Andaj, në rastin konkrete fatura nuk përmbanë objektin për të cilin kreditori ia ka lëshuar debitorit këtë faturë ngase nuk është përcaktuar shërbimi si dhe shuma e faturës në fjalë nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë, sepse ajo nuk përmbanë vetëm borxhin për periudhën kohore të faturuar por

edhe një borxh tjetër paraprak, prejardhja dhe periudha kohore e krijimit të tij nuk dihet, kështu që dokumenti i besueshëm nuk është i përshtatshëm për përmbartim ashtu sipas dispozitës së cekur më lartë.

Andaj, Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi të gjitha pretendimet e ankimuara por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.ShII.nr.103/24 me datë 08.10.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri